# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-453416**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “U përndoqa dhe u fyeva” - Deputetja Luarasi flet për videon e sulmit verbal: 730 komente që flisnin për varje dhe pushkatim |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/u-perndoqa-dhe-u-fyeva-deputetja-luarasi-flet-per-videon-e-it-verba-i586771` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 19:54:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 19:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `17bec95778884d8187a41bd30ec900e176d6fe5c752ea4a60aa027506b9d2913` |
| TEKSTI | `770f3101e86d405930bef407d1f777dbf5f4bddfbcb414acee542232235a07e0` |
| PAMJA | `62697aaff8ef58c06fea478050c2c893611fb6d6fc5bd05979bf323423f7b3d2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6f5cbf546e80e57f24015adc371029ade467c1707464bb4e96c41638a70c86bf` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b36d3d1202e685b83ffcf611c8f22a5defe9644c370970134944b31e37e025b7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6f5cbf546e80e57f24015adc371029ade467c1707464bb4e96c41638a70c86bf`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "U përndoqa dhe u fyeva" - Deputetja Luarasi flet për videon e sulmit verbal: 730 komente që flisnin për varje dhe pushkatim

17 Shtator 2026, 21:50Politika TEMA



Deputetja e Partisë Socialiste, gjatë fjalës së saj sot në Kuvend, Iris Luarasi, është ndalur te sulmi verbal që iu bë pak ditë në një qendër tregtare teksa po shkonte në seancë, nga një grup protestuesish.

Ajo tha se në 5 ditë, videoja është shpërndarë gjerësisht dhe se pjesë më e madhe e komenteve kanë qenë fyese dhe denigruese, apo me gjuhë urrejtjeje dhe dhune ndaj saj, duke ngritur si shqetësim dhunën online.

"Të gjithë ju e keni parë se një javë më parë ndërsa po vija drejt seancës plenare, duke ardhur për në foltore, u përndoqa nga një grup që më ngjanin me pionerët e Enverit, që ulërinin fyerje që mendoj se nuk i meritoj.

Kjo është një video që u pa nga miliona njerëz, dhe nuk jam këtu për ta ritreguar, por për të ritreguar atë që ndodhi pas videos.

Ajo që pasoi monitoruar në mënyrë të pavarur publikim pas publikimi, për 5 ditë, emri u përmend në 708 artikuj, në 64 media online, në 134 llogari të emërtuara. Shtrirja e përgjithshme 14.9 milionë. Shikimet 4.8 milionë. Dhe 80 % e të gjithë kësaj ndodhi brenda 48 orëve. Nga këto 730 komente ndëshkuese, ose potencialisht të dhunshme, burg, zhdukje, varje, djegie, pushkatim.

Jo çdo fyerje është gjuhë urrejtjeje në kuptimin ligjor, por 730 komente që flasin për varja për një grua që ecën nëpër një qendër tregtare për të shkuar në punë, nuk janë debat politik, por siç Konventa e quan në nenin 5 'rrezik për aksesin e drejtpërdrejtë dhe të barabartë në debatin publik'. Sot nuk flas si viktimë por si relatorja që ka të dhëna", u shpreh deputetja.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Tabaku në Kuvend: Paratë dhe asetet publike nuk mund të administrohen pa transparencë]

21:40 Politika

[Pagat e magjistratëve/ Bylykbashi prezanton draftin e PS: Rritje sa 2% e pagës së Presidentit]

21:30 Politika

[Flamingot e hershme të Shtëpisë së Verdhë]

20:50 Politika / 4 komente

[Jetimët' e UÇK në Hagë, Albini që zhbëri Kosovën dhe 'lotët' e Berishës]

19:31 Politika / 15 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.